



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR

2016

Përmbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTESAT	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. KORNIZA LIGJORE.....	8
2.2. Përmirësimi i bazës ligjore:	9
2.2.1. Harmonizimi i Rregulloreve ekzistuese:	9
2.2.2. Hartimi i akteve të reja nënligjore (Rregulloreve):	9
2.3. Vështirësitë ligjore :	10
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	11
3.1. Vizioni/Misioni	11
3.2. Kompetencat e ARRU, sipas Ligjit	11
4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT.....	13
4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit	15
4.2. Bordi.....	16
4.3. Ekzekutivi	16
4.4. Burimet Njerëzore	16
4.5. Asetet	17
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE.....	18
5.1. Licencimi i ofruesve të shërbimit	18
5.1.1. Amandamentimi i licencave të shërbimit	19
5.2. Amandamentimi i akteve nënligjore (rregulloreve)	19
5.3. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave).....	20
5.3.1 Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve.....	20
5.3.2. Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative	21
5.3.3. Përmbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit.....	22
5.4. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit 2015-2017	22
5.5. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit	26
5.5.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit	27
5.5.2. Uji i Pa faturuar (UPF)	29

5.5.3. Shkalla e arkëtimit.....	31
5.5.4. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës.....	32
5.5.5 Performanca e NHE-Iber Lepenci.....	33
5.6. Inspektimi dhe zbatimi i standardeve të shërbimit	33
5.6.1. Inspektimi i zbatimit të rregullores për standardet minimale të shërbimeve	33
5.6.2. Verifikimi i mënyrës së matjes së ujit të prodhuar në të gjitha pikat e prodhimit.	34
5.6.3. inspektimi i zbatimit të akteve nënligjore, urdhëresave dhe vendimeve të ARRU.	34
5.7. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve(KKK)	35
5.7.1 Shqyrtimi i ankesave:	37
5.8. Aktivitetet në konsolidimin institucional	38
5.8.1. Aktivitetet në planin legjislativ.....	38
5.9. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA	39
5.10. RELACIONET ME PUBLIKUN	42
5.10.1. Bashkëpunimi me media.....	42
5.10.2. Hulumtimi i opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujit.....	42
6. REKOMANDIMET.....	44
7. RAPORTI FINANCIAR	45
8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	47

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ARRU – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e ujit

AKMM – Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

AMK – Agjencin e metrologjisë së Kosovës

BB – Banka Botërore

BWA – Bulgarian Water Association (Shoqata e Ujërave të Bullgarisë)

DANUBIS – programi I benchmarkingut të vendeve të regjionit të Danubit

DWP – Danube Water Program (Programi I Ujërave të Danubit)

ESK – Enti I Statistikave të Kosovës

ERRU – Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura
(Shqipëri)

IKSHPK – Instituti Kombëtar I Shëndetit Publik të Kosovës

IBNET – International Benchmarking Network (Rrjeti Ndërkombëtar I Benchmarkingut)

IWAD – Shoqata ndërkombëtare e kompanive të ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub

KBPMPPH – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

KNMU – Këshilli Ndërministror i Ujit

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjetës

KKK – Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

KK – Kuvendi Komunal

KE – Komisioni European

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MIE – Ministria e Integritimit Evropiane

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

NHE – Ndërmarrje Hidro Ekonomike

NPK – Ndërmarrja Publike Komunale

NJPM – Njësia për Politika e Monitorim

Nj.O. – Njësia Operative

SHUKOS – Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës

SHUKALB – Shoqata e Ujësjetës Kanalizimeve Shqipëri

TKP – Treguesit Kyç të Performancës

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të nderuar/a,

Si çdo vit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), paraqet para jush Raportin vjetor të punës si detyrimi ligjor bazuar në Ligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit (Ligji Nr.05/L-42). Raporti paraqet aktivitetet dhe arritjet e institucionit në përmbushjen e mandatit ligjor për vitin raportues, si dhe një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Përmbushja e obligimeve dhe zbatimi i planit të punës për vitin 2016 ka qenë mjaft sfidues për ARRU, për arsye të vonesës së zgjedhjes së menaxhmentit kryesor (Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit) nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Pamundësia për të finalizuar disa nga aktivitetet e parapara në gjysmën e parë të vitit 2016, për shkak të moszgjedhjes së Drejtorit dhe Zv. Drejtorit, kanë shkaktuar vonesa në disa prej aktiviteteve siç janë: licencimi i ofruesve të shërbimeve, amandamentimi dhe nxjerrja e akteve nënligjore (rregulloreve), nxjerrjes së udhëzimit administrativ për TVL, pas hyrjes në fuqi të Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit etj.

Megjithatë me një angazhim të madh të të gjithë të punësuarve të ARRU, menjëherë pas zgjedhjes së Drejtorit me 28 prill 2016, kemi arritur t'i përmbushim të gjitha aktivitetet e parapara për vitin 2016.

Viti 2016 shënoi hyrjen në fuqi të Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit (Nr.05/L-042), përmes të cilit ndikimi dhe roli i ARRU në rregullimin e pavarur stabil dhe ekonomik është fuqizuar, gjë që nënkupton detyra dhe angazhime shtesë për stafin ekzistues të institucionit tonë.

Ndër aktivitetet me prioritet të lartë të ARRU gjatë vitit 2016, menjëherë pas zgjedhjes së Drejtorit, ka qenë përtrirja e licencave të ofruesve të shërbimit me ujë. Përtrirja e licencave të ofruesve të shërbimeve është bërë me datë 31 maj 2016, me vlefshmëri të licencës deri më 10 shtator 2018. Edhe pse në bazë të Ligjit Nr.05/L-042, ofruesit e shërbimeve mund të licencohen nga një deri në dhjetë vjet, ofruesit e shërbimeve janë licencuar për aq kohë sa kanë vlefshmëri të shfrytëzimit të burimeve të ujit, sipas lejeve ujore të lëshuara nga MMPH.

Sipas obligimeve të dhëna me Ligjin Nr.05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit, gjatë vitit 2016, ARRU ka amandamentuar gjashtë (6) akte nënligjore (Rregullore) dhe është nxjerrë një akt nënligjor i ri.

Për rregullimin (funktionimin) e brendshëm të ARRU, bazuar në obligimet dhe kompetencat e dhëna me Ligjin Nr.05/L-042 janë nxjerrë tri (3) akte të brendshme nënligjore (Rregullore), si

dhe është aprovuar struktura e re organizative. Duke vërejtur se inspektimi i drejtpërdrejtë në terren gjatë viteve të fundit ka dhënë rezultate pozitive, përmes strukturës së re organizative është themeluar njësi e inspektimit, me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të këtij aktiviteti.

Viti 2016 ka shënuar vitin e dytë të periudhës së rregullt tarifore tri (3) vjeçare 2015-2017. Sikurse edhe në vitet paraprake, përmes rishikimit të tarifave, ARRU është munduar të mbajë ekuilibër për të siguruar që konsumatorët të marrin shërbime të cilësisë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm duke pasur gjithmonë parasysh edhe qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.

Me qëllim të harmonizimit me ligjin, lehtësimit dhe stimulimit të konsumatorëve për qasje në shërbimet e ujit, janë korrigjuar disa nga tarifatat dytësore përmes urdhërësës tarifore siq janë :(i) largimi i gjobave për lidhje dhe rilidhje ilegale, për mos riparim të rrjedhjeve, si dhe është zbritur taksa administrative për lidhje në shërbime të ujit nga 50.00 € në 5.00 €.

Shkalla e përmbushjes së caqeve (objektivave) të përcaktuara me procesin rregullator të tarifave, shkalla e realizimit të investimeve kapitale gjatë periudhës së shikuar, lëvizjet inflatore, krijimi i parakushteve për qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve dhe mundësia e pagesës së faturave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve, kanë qenë faktor determinues gjatë procesit të rishikimit të tarifave për vitin 2017.

Vlen të theksohet se tarifatat e aprovuara nga ARRU në fund të vitit 2016, me Urdhërësë Tarifore, për të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve, për vitin 2017 janë të njëjta si të dy viteve paraprake.

Është ky viti i dhjetë me radhë që përmes Raportit të Performancës ARRU vlerëson ecurinë dhe ngecjet e ofruesve të shërbimeve të ujit. Informatat, analizat dhe të dhënat e këtij raporti pasqyrojnë gjendjen e sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen. Ky raport mund të ndihmojë ofruesit e shërbimeve, politikë-bërësit e sektorit por edhe vet konsumatorët për të pasur një pasqyrë reale të gjendjes së sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Përmbushja e Standardeve Minimale të Shërbimit nga ana e ofruesve të shërbimeve është obligative dhe njëkohësisht është edhe mjeti më efikas i cili siguron promovimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Prandaj edhe përcjellja intensive e përmbushjes së këtyre standardeve përmes inspektimeve të vazhdueshme në terren edhe gjatë vitit 2016 ka qenë ndër aktivitetet kryesore të punës së ARRU.

Duke u bazuar në misionin që ka ARRU, gjatë tërë vitit kemi përkrahur KKK, në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve të cilët kanë qenë të pakënaqur me zgjidhjen e ankesave të tyre nga ofruesit e shërbimeve.

Me ndihmën e projektit mbështetës të ARRU, të financuar nga Qeveria Zvicerane, kemi bashkëpunuar ngushtë me ofruesit e shërbimeve në përpilimin e formatit të ri të kontratës së shërbimeve dhe kartën e konsumatorit (në përputhje me aktet nënligjore në fuqi). Përveç përmbushjes së obligimeve ligjore, përmes këtyre dy dokumenteve të aprovuara nga ARRU, konsumatorët kanë mundësinë e informimit më të hollësishëm për të drejtat dhe obligimet e tyre ndaj ofruesve të shërbimeve dhe anasjelltas.

Me iniciativë dhe financim të ARRU është realizuar hulumtimi i opinionit të konsumatorëve për shërbime të ujit në Kosovë, duke përfshirë aspektin financiar, teknik dhe shërbimin me konsumatorë. Anketimi është realizuar me konsumatorë shtëpiak në njëzet e tetë (28) komuna të shtatë (7) rajoneve të Kosovës në zonat e shërbimit në të cilat KRU-të ofrojnë shërbime, gjatë të cilit janë anketuar gjithsej 1143 konsumatorë. I gjithë procesi ka qenë i monitoruar nga ARRU dhe Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve. Rezultatet e këtij hulumtimi do të na shërbejnë për tu angazhuar edhe më tej duke u fokusuar në temat të cilat kanë rezultuar jo të kënaqshme.

Bashkëpunimi me palët brenda dhe jashtë vendit ka qenë një ndër aktivitetet e ARRU edhe gjatë vitit 2016. Sipas kërkesave të institucioneve të ndryshme siç janë: MIE, DANUBIS, IBNET, IWAD, etj janë përgatitur dhe dorëzuar raportet. Përmes pjesëmarrjes aktive në takime dhe punëtori të organizuara brenda dhe jashtë vendit, kemi dhënë kontribut duke prezantuar përvojat tona, si dhe duke marrë përvojat e mira të institucioneve tjera.

Në këtë drejtim vlen të theksohet se është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me shoqatën ndërkombëtare të kompanive të ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub (IAWD)-DANUBIS, që ka për qëllim bashkëpunimin në zhvillimin e përbashkët dhe menaxhimin e Platformës për mbledhjen e të dhënave për performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sektorit.

Pjesë përbërëse e këtij Raporti është edhe Raporti Financiar përmes të cilit janë dhënë sqarime lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe asetet e ARRU.

Sikur gjatë vitit 2016 edhe në të ardhmen, ARRU me të njëjtin përkushtim do të kontribuojë në rritjen e profesionalizmit, transparencës, bashkëpunimit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë që me autoritetin e tij rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur mes ofruesve të shërbimit, politikë-bërësve dhe konsumatorit.

Shpresoj se informacionet dhe rekomandimet e këtij Raporti do të jenë të dobishme për të gjitha palët e interesit të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e politikave të sektorit të ujit në Kosovë.

Sfida do të vazhdojmë të kemi edhe në vitet në vijim, por arritjet gjatë vitit 2016 janë një hap para për të vazhduar edhe më tej përmirësimin e këtij sektori.

Në fund dua të falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për Aprovimin e Ligjit për rregullimin e shërbimit të ujit, stafin e ARRU, ofruesit e shërbimeve, projektin mbështetës të ARRU (financuar nga SDC) dhe të gjithë bashkëpunëtorët e këtij sektori për punën e tyre.

Raif Preteni



Drejtor i ARRU

2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 “Ligji për Ndryshimin e Rregullores 2004/49 mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave” të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, me ç’rast raportimi i ZRRUK (emërtim i mëhershëm) nga UNMIK-u ka kaluar te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbeturina (Nr. 04/L-060) më 08 qershor 2012, përgjegjësitë dhe kompetencat e sektorit të mbeturinave janë bartur te Qeveria e Kosovës dhe MMPH, pra që nga miratimi i këtij Ligji ZRRUK nuk është përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të Ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Duke u nisur nga ky fakt ZRRUK ka marrë iniciativë për të propozuar iniciimin e procedurave për amendamentimin e Ligjit Nr. 03/L-086.

Më 30 janar 2016 ka hyrë në fuqi Ligji Nr.05/L-042, Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i cili ka për qëllim rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe ndryshimit të emërimit nga ZRRUK në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

2.1. Baza ekzistuese ligjore e cila rregullon funksionimin e ARRU:

- Ligji për rregullimin e shërbimeve të Ujit - Ligji Nr.05/L-042

Sipas autorizimeve të dhëna nga kjo bazë ligjore dhe legjislacionit tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit, ARRU përmes akteve nënligjore (Rregulloreve) që kanë hyrë në fuqi në vitin 2016, ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme rregullimin e fushave të veçanta për të cilat ky institucion është përgjegjës.

Në vijim janë listuar Rregulloret e ARRU:

- Rregullore për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr.01/2016)
- Rregullore për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 02/2016)
- Rregullore për kartën e konsumatorëve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 03/2016)
- Rregullore për Inspektimin e përmbushjes së obligimeve rregullatore nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr.04/2016)
- Rregullore për licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 05/2016)
- Rregullore për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 06/2016)
- Rregullore për përcaktim të tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 07/2016)

- Rregullorja e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare (Nr.01/2016)
- Rregullorja e brendshme për kontrollimin financiar në ARRU (Nr 02-AF/2016)
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (Nr.03-OB/2016)

2.2. Përmirësimi i bazës ligjore:

Në harmonizim me Ligjin Nr.05/L-042, gjatë vitit 2016, ARRU ka amendamentuar gjashtë (6) akte nënligjore (Rregullore) dhe ka nxjerrë një (1) akt të ri nënligjor (Rregullore), si dhe tri (3) akte të reja të brendshme nënligjore (Rregullore).

2.2.1. Harmonizimi i Rregulloreve ekzistuese:

Gjatë periudhës raportuese (vitit 2016) janë amendamentuar dhe harmonizuar me Ligjin, Rregulloret ekzistuese të paraqitura në vijim:

- Rregullorja për komisioni këshillues të konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 01/2016)
- Rregullorja për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 02/2016)
- Rregullorja për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 03/2016)
- Rregullorja për licencimin e ofruesve të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 05/2016)
- Rregullorja për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 06/2016)
- Rregullorja për përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 07/2016)

2.2.2. Hartimi i akteve të reja nënligjore (Rregulloreve):

Sipas kërkesave të Ligjit është nxjerrë një (1) akt nënligjor (Rregullore) dhe tri (3) akte nënligjore (Rregullore) të brendshme.

- Rregullorja për inspektimin e përmbushjes së obligimeve rregullatore nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr.04/2016)
- Rregullorja e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare (Nr.01/2016)
- Rregullorja e brendshme për kontrollimin financiar në ARRU (Nr 02-AF/2016)
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (Nr.03-OB/2016)

Varësisht nga vlerësimet dhe nevojat e paraqitura nga palët e interesit, baza ligjore rishqyrtohet dhe mund të pësojë edhe ndryshime.

2.3. Vështirësitë ligjore :

Në pajtim me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është paraparë obligimi i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) që të nxjerr rregulloren për masat ndëshkuese (sanksionuese) në rast të mos respektimit të Ligjit nr.05/L-042 dhe akteve nënligjore të ARRU.

Mirëpo në anën tjetër në shtator të vitit 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për kundërvajtje Nr.05/L-087, dhe hyn në fuqi në vitin 2017, ku parashihet që kundërvajtjet nuk mund të përcaktohen me akt nënligjor.

ARRU iu është drejtuar Komisionit për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka kërkuar opinion ligjor për Rregulloren për masat ndëshkuese dhe të njëjtit kanë rekomanduar që në vitin 2017 të fillohet me Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë, i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujësjetës, kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Kosovë.

3.1. Vizioni/Misioni

Vizioni:

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe eficientë të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni:

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

3.2. Kompetencat e ARRU, sipas Ligjit

Bazuar në kornizën ligjore aktuale, si institucion përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesve të shërbimeve ka kompetenca për:

- Licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit,
- Përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve,
- Vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve,
- Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për të vlerësuar nëse ata i përmbushin kushtet e përcaktuara me licencën e shërbimit, si dhe caqet e përcaktuara me procesin tarifor,
- Themelimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës,

- Hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr.05/L-042 dhe ligjeve tjera të aplikueshme,
- Inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

Në vijim janë përshkruar përgjegjësitë kryesore të njësive organizative të ARRU, funksionimi i të cilave mundëson përmbushjen e kompetencave të cekura më lart dhe detyrave tjera të përcaktuara me ligj:

Departamenti për çështje ligjore dhe licencim: siguron mbështetjen ligjore. Ky departament gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore përveç që bazohet në ligjet e Republikës së Kosovës, si pikë reference, ka edhe direktivat dhe rregulloret e Unionit Evropian. Gjithashtu menaxhon procesin e licencimit të ofruesëve të shërbimeve të ujit përfshirë edhe vlerësimin, në baza të rregullta, të përmbushjes së kushteve të licencimit, si dhe propozimin e masave për përmirësim. Departamenti poashtu ofron ndihmë profesionale dhe monitoron punën e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve.

Departamenti për tarifa: siguron mbështetje në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit. Ky proces përfshin caktimin e caqeve të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara. Përmes këtij procesi, departamenti siguron gjetjen e bilancit në mes të mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit. Ky departament siguron, në baza të rregullta, vlerësimin e përmbushjes së caqeve dhe propozimin e masave për përmirësim.

Departamenti për raportim të performancës: siguron mbështetje në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve tarifore. Ky departament bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

Departamenti për administratë dhe financa: siguron mbështetje administrative. Ky departament mbështet udhëheqjen e Autoritetit për një funksionim normal të departamenteve duke menaxhuar burimet njerëzore, buxhetin dhe financat e Autoritetit, aktivitetet ndihmëse, si dhe koordinimin e furnizimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit.

Njësia për inspektim: siguron mbështetje në aktivitetin e inspektimit në përgjithësi dhe raportimin dhe inspektimin e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të ujit, në veçanti duke përfshirë grumbullimin, inspektimin në vend-ndodhje, përpunimin e të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT

Fushëveprimi i Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit përfshin ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë.

Në vijim janë paraqitur ndërmarrjet e licencuara nga ARRU të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë, të cilat veprojnë në Kosovë, rregullimin ekonomik të të cilave e bën ARRU.

Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bë nga ARRU me datën 31.05.2016, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042, si dhe me procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh.

Aktualisht të gjitha ndërmarrjet në vijim janë të licencuara deri me 10.09.2018.

(i) Kompanitë e licencuara për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit):

- KRU “Prishtina” Sh. A., që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë
- KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë Dragash dhe Mamushë
- KRU “Hidrodrini” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan
- KRU “Mitrovica” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri
- KRU “Radoniqi” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe disa fshatra të Prizrenit
- KRU “Hidromorava” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti
- KRU “Bifurkacioni” Sh.A., që ofron shërbimet në komunën: Ferizaj dhe Kaçanik

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU.

(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

- **“Ibër-Lepenci” Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.


Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjetës dhe Kanalizimit



KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Radoniqi	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KRU-të
							
Prishtina Podujeva Fushë Kosova Obiliçi Lipjani Drenasi Shtime Graçanica	Prizreni Suhareka Malisheva Dragashi Mamusha	Peja Istogu Klina Juniku Deçani	Mitrovica Skenderaj Vushtrria	Gjakova Rahoveci Prizren (disa fshatra)	Ferizaj Kaçaniku	Gjilani Kamenica Vitia	Novobërda Zubin Potoku Leposaviçi Zveçani Shtërpce, Hani i Elezit, Partesh, Rani Ilug, Mitrovica e veriut, Kllokot

4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit

ARRU aktivitetet e veta i përmbush sipas organizimit të paraqitur në organogram



4.2. Bordi

Autoriteti rregullator për shërbime të ujit, sipas Ligjit Nr.05/L-042 nuk ka Bord.

4.3. Ekzekutivi

a) Drejtori i dhe Zëvendës Drejtori i ARRU

Drejtori i ARRU është përgjegjës për: administrimin, menaxhimin dhe organizimin e ARRU, punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative, menaxhimin e resurseve dhe buxhetit të ARRU, përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit si dhe detyrat tjera të përcaktuara me ligjin Nr. 05/L-042

Zëvendës drejtori i ARRU: ndihmon drejtorin në kryerjen e detyrave të tij. Në mungesë të drejtorit, ARRU udhëhiqet nga zëvendësdrejtori.

b) Menaxhmenti i mesëm i ARRU

Menaxhmenti i mesëm përbëhet nga kryesuesit/udhëheqësit e njësive organizative të ARRU të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e njësive organizative përkatëse, bashkëpunim me njësitë tjera organizative të ARRU, këshillojnë drejtorin lidhur me temat specifike të njësive organizative përkatëse si dhe detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren 03-OB/2016.

c) Mandati

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar.

- Drejtori është zgjedhur me 28 prill 2016 dhe ka mandat deri me 28 prill 2021,
- Zëvendës Drejtori është zgjedhur me 28 tetor 2016 dhe ka mandat deri me 28 tetor 2021.

4.4. Burimet Njerëzore

a) Numri i përgjithshëm i punëtorëve në ARRU është nëntëmbëdhjetë (19)

b) Për vitin 2017 është planifikuar të rritet numri i punëtorëve me dy punëtorë (mvarësisht nga mjetet e lejuara financiare pas rishikimit të buxhetit)

c) Me qëllim të ngritjes profesionale, si çdo vit edhe për vitin 2016 është përgatitur plani vjetor i trajnimeve për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2016 për të punësuarit e ARRU.

Edhe pse për çdo vit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit bën planifikimet e trajnimeve për personelin e vet dhe e dorëzon në Ministrinë e Administratës Publike, shumica e trajnimeve nuk është realizuar sepse MAP nuk organizon trajnime për të cilat ka nevojë personeli i ARRU-së.

4.5. Asetet

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i thesarit.

Vlera e aseteve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2016 në ARRU është 22,984.25euro. Asetet mbi 1000 euro 3,045.00 dhe asetet nën 1000 euro 19,939.25

4.5.1. Asetet e ARRU janë mjetet e punës përmes të cilave i përmbushim obligimet tona. Në këto mjete bëjnë pjesë: vetura (5), kompjuterë, laptopë, printerë, fotokopje, server, tavolina, karrige.

ARRU aktualisht është me seli në Bregun e Diellit, Rr. “ Ferat Dragaj”, nr. 68 – Prishtinë, në objekt privat për të cilin paguajmë qira, edhe përkundër shumë kërkesave drejtuar MAP-it për të na ofruar zgjidhje.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

ARRU ka obligim ligjor dhe detyrë që përmes aktiviteteve të veta dhe autoritetit të dhënë me ligj të sigurojë se ofruesit e licencuar të shërbimeve zbatojnë Ligjin dhe Rregulloret në fuqi, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së konsumatorëve, transparencës në punë dhe stimulimin e konkurrencës mes tyre. Përmeshja e këtyre obligimeve edhe gjatë vitit 2016 është arritur përmes aktiviteteve dhe detyrave të parapara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor të Punës.

Për ti pasur më të qarta aktivitetet, hapat, masat dhe veprimet e Institucionit tonë, si dhe për ti dhënë lexuesit të këtij Raporti një pasqyrim të përgjithshëm të gjendjes së sektorit të ujit në Kosovë, në vijim janë paraqitur aktivitetet, procedurat dhe rezultatet e aktiviteteve të ARRU për periudhën raportuese.

Duhet të theksojmë se për shkak të vonesës së zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të ARRU aktivitetet të cilat kanë kërkuar vendimmarrje gjatë vitit 2016 kanë filluar me vonesë.

5.1. Licencimi i ofruesve të shërbimit

Nga data 31 tetor 2015 (datë në të cilën të gjithë ofruesëve të shërbimit u ka skaduar vlefshmëria e licencës) deri me datë 31 maj 2016 të gjithë ofruesit e shërbimeve kanë operuar pa licenca të shërbimit për arsye të vonesës së zgjedhjes së ekzekutivit të ARRU.

Aktiviteti I përtrirjes së licencave të ofruesve të shërbimit ka qenë aktiviteti primar i ARRU menjëherë pas zgjedhjes së Drejtorit.

Përtrirja e licencave të ofruesve të shërbimeve është bërë me datë 31 maj 2016 në afat 3 vjeçar. Aktualisht të gjithë ofruesit e shërbimeve kanë licencë të vlefshme deri me datë 10 shtator 2018.

Arsyeja e licencimit në kohëzgjatje 3 vjeçare (edhe pse në bazë të Ligjit Nr.05/L-042, ofruesit e shërbimeve mund të licencohen nga një (1) deri në dhjetë (10) vjet) është për shkak të vlefshmërisë së lejeve ujore të lëshuara nga MMPH. Vlefshmëria e lejeve ujore nga MMPH është një ndër kushtet e licencimit. Lejet ujore të paraqitura me rastin e aplikimit për licencë nga ofruesit e shërbimeve kanë vlefshmëri deri me datë 10 shtator 2018.

Komunat Shtërpce, Novo Bërd, Partesh, Kllokot, Ranillug dhe Hani I Elezit planifikohet të integrohen në kompanitë rajonale përkatëse, pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre. Rehabilitimi është planifikuar përmes investimeve të fazës së V-të të projektit të SDC (investim i Qeverisë Zvicerane). Marrëveshjet me komunat përkatëse janë nënshkruar dhe integrimi do të bëhet pas pranimit teknik të punëve.

Në Mitrovicën veriore vazhdon të operojë pa licencë ofruesi i shërbimeve NPK "Vodovod Ibar". ARRU në vazhdimësi ka bërë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi, bazuar në autoritetin e dhënë me ligj (neni 4.3.1) përmes procedimit të letrave dhe paralajmërimeve. Meqenëse nuk

kemi pasur asnjë përgjegje pozitive, përkundër që shkresat janë kthyer me arsyetimin e refuzimit të pranimit, në pajtim me Ligjin Nr.05/L-042, ARRU ka inicuar procedurë gjyqësore me datë 30 shtator 2014 – akoma jemi në pritje të reagimit të gjykatës.

Aktualisht kompanitë e licencuara janë:

- i. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Prishtina” Sh.A. Prishtinë;
- ii. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidrodrini” Sh.A. Pejë;
- iii. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren;
- iv. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Hidromorava” Sh.A. Gjiilan;
- v. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Radoniqi” Sh.A. Gjakovë;
- vi. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Bifurkacioni” Sh.A. Ferizaj;
- vii. Kompania Rajonale e Ujësjiellësit “Mitovica” Sh.A. Mitrovicë;
- viii. NPH “Ibër-Lepenci” Sh.A. Prishtinë

5.1.1. Amandamenti i licencave të shërbimit

Sipas kërkesës së KRU “Radoniqi”, është bërë amendamenti i Licencës së Shërbimit. Amandamenti ka të bëjë me përfshirjen e fshatit Lubizhdë e Hasit në zonën e shërbimit të KRU “Radoniqi”. Duke pasur parasysh se ky fshat ka qenë në zonën e shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, rrjedhimisht është bërë edhe ndryshimi i licencës së shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”. Ky aktivitet është ndërmarrë me qëllim të zgjidhjes së problemit të furnizimit me ujë të banorëve të këtij fshati, dhe me miratimin e të gjitha palëve të interesit (KRU “Hidroregjioni Jugor”, KRU “Radoniqi”, MZHE dhe përfaqësuesit e fshatit).

5.2. Amandamenti i akteve nënligjore (rregulloreve)

Në harmonizim me Ligjin Nr.05/L-042, gjatë vitit 2016, ARRU duke pasur edhe mbështetjen nga projekti mbështetës i SDC ka amendamentuar gjashtë (6) akte nënligjore (Rregullore), ka nxjerrë një (1) akt të ri nënligjor (Rregullore), si dhe tri (3) akte të brendshme të reja nënligjore (Rregullore).

Janë amendamentuar:

- Rregullorja për komisioni këshillues të konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 01/2016)
- Rregullorja për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 02/2016)
- Rregullorja për kartën e konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 03/2016)
- Rregullorja për licencimin e ofruesve të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 05/2016)
- Rregullorja për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 06/2016)
- Rregullorja për përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 07/2016)

Janë hartuar (nxjerrë):

- Rregullorja për inspektimin e përmbushjes së obligimeve rregullatore nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr.04/2016)
- Rregullorja e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare (Nr.01/2016)

- Rregullorja e brendshme për kontrollimin financiar në ARRU (Nr 02-AF/2016)
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (Nr.03-OB/2016)

5.3. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave)

Përmes këtij aktiviteti monitorohet përmbushja e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ARRU përmes procesit tarifor. Përmbushja apo mospërmbushja e këtyre caqeve është një ndër faktorët determinues për përcaktimin e tarifave të vitit pasues.

Procedurat e monitorimit kryhen nga analizimi i të dhënave për përmbushje apo mospërmbushje të caqeve të aprovuara, të treguesve kryesor –të cilët janë të njëjtë për analizimin e të gjitha kompanive.

Të dhënat sigurohen nga raportimet në baza mujore dhe raportet vjetore të KRU-ve, të cilat si plotësisht të vlefshme llogariten pasi të ketë përfunduar procesi i analizimit dhe auditimit nga stafi profesional i ARRU.

Pasqyra e plotë e afarizmit të të gjitha KRU-ve dhe sektorit do të dihen me përmbylljen e librave financiare të vitit 2016, të cilat duhet të kompletohen gjer në fund të Marsit të vitit 2017.

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përmbushjes së caqeve për vitin 2016 janë të dhëna të pa audituara (meqenëse pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur) ndërsa të dhënat e vitit 2015 janë të verifikuara me procesin e auditimit. Të dhënat e vitit 2016 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.

Në vijim të këtij raporti, përmes tabelave dhe shpjegimeve është paraqitur shkalla e përmbushjes së caqeve të aprovuara nga ARRU të disa prej treguesve kryesor në nivel të sektorit nga ana e ofrueve të shërbimeve gjatë vitit 2016. Për të dhëna të plota mund të shikoni: <http://www.arru-rks.org>. *Tarifat, Raportet, Raport mbi Vlerësimin e Përmbushjes së Caqeve për periudha të caktuara të vitit 2016 nga procesi rregullator i tarifave të periudhës 2015-2017.*

Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare, ku janë pasqyruar të dhënat e vitit 2015 (për krahasim) të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2016, të dhënat e realizuara gjatë vitit 2016, përqindja e përmbushjes/mospërmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtar .

5.3.1 Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve

Për analizën e të dhënave operative kemi marrë parasysh të dhënat sasiore për metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (IV) ujërat e ndotura të faturuara; (V) numri i konsumatorëve.

<i>Të dhënat për shërbimet e sektorit të ujit</i>	<i>Njësia matëse</i>	<i>Realizuar për 2015</i>	<i>Aprovuar për vitin 2016</i>	<i>Realizuar për vitin 2016</i>	<i>Ndryshimi ne %</i>	<i>Vlerësimi</i>
Uji i prodhuar	m ³	137,044,281	142,984,787	143,597,279	100%	R
Uji i humbur	m ³	77,300,666	71,509,938	81,646,540	114%	Jo e R
Uji i faturuar	m ³	59,743,615	71,474,848	61,950,739	87%	Jo e R
Konsumatorët	Nr	300,032	301,320	322,895	107%	R

Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave historike sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë vitit 2015, krahasuar me të dhënat e aprovuara dhe realizuara për vitin 2016 me te cilat vlerësohet shkalla e përmbushjes së caqeve të periudhës së përcaktuar me vlerësimin e DFTRR/ARRU për sektorin.

Sqarimi i shkurtesave për vlerësimin: Jo e R = Jo e realizuar- vlerësim negativ, R = Realizuar- vlerësim pozitiv

Të dhënat sektoriale të lartë cekura pasqyrojnë shkallën e realizimit dhe mos realizimit të objektivave për grupimin e parë të katër treguesit bazik të përcaktuar për vitin biznesor 2016. Nga të dhënat e lartë cekura mund të konkludojmë se; sektori ka arrit të realizojë objektivin e sasisë së ujit të prodhuar dhe numrit të konsumatorëve të shërbyer, ndërsa ka dështuar në masë të theksuar arritjen e caqeve të përcaktuar për ujin e humbur dhe sasinë e ujit të faturuar. Duke marr parasysh faktin se ofruesit e shërbimeve kanë dështuar të arrijnë objektivat e përcaktuara për ujin e humbur dhe sasinë e ujit të faturuar edhe prodhimi i ujit nuk mund të konsiderohet si objektiv i përmbushur.

5.3.2. Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative

Në formë tabelare (tabela Nr.2) janë paraqitur të dhënat sektoriale për shpenzimet operative, duke paraqitur kostot paraprake të shërbimeve të ujit për vitin 2015 dhe ato të aprovuara dhe realizuar gjatë vitit 2016, të cilat na mundësojnë krahasimin e këtyre të dhënave dhe vlerësimin e shkallës së përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2016.

<i>Të dhënat për shërbimet e sektorit të ujit</i>	<i>Njësia mone ta</i>	<i>Σ e shpenzimeve për vitin 2015</i>	<i>Σ e aprovuar nga ARRU 2015</i>	<i>Σ e realizuar nga KRU-të 2016</i>	<i>% e realizim. të caktut për vitin 2016</i>	<i>Vlerësimi</i>
Shuma e Shpenzimeve operative sektoriale	€	22,393,984	20,786,900	22,525,598	108%	(N) Negativ

Tabela Nr. 2. Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative gjatë vitit 2015 për tu krahasuar me të dhënat e vitit 2016, me caqet e aprovuara dhe realizuara të vitit 2016, me % krahasimin e të dhënave të aprovuara dhe realizuara për këtë viti dhe me vlerësimin e ARRU

Siq edhe shifet nga tabela e mësipërme, kostot e operimit gjatë vitit 2016 kanë qenë ma të larta se ato të aprovuara për vitin 2016 për 8%. Shkalla e lartë e tejkalimit të kostove nga ato të aprovuara nga ARRU nuk mund të arsyetohet.

5.3.3. Përmbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim për vitin 2015 dhe ato të aprovuara dhe realizuara nga sektori për vitin 2016, me % dhe vlerësimin për këto të dhëna.

<i>Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit</i>	Njësia monet.	Σ e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2015	Σ e faturimit dhe arkëtimit të aprovuar për vitin 2016	Σ e faturimit dhe arkëtimit të realizuar për vitin 2016	% e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2016	Vlerësimi
Shuma e faturimit	€	31,468,008	36,149,503	31,593,829	87%	Jo e R (Negativ)
Shuma e arkëtimit	€	22,630,486	28,072,094	27,204,199	97%	Jo e R Negative

Tabela Nr. 3. Pasqyra e të dhënave historike të faturimit dhe arkëtimit gjatë vitit 2015, krahasuar me të dhënat e aprovuara dhe realizuara për vitin 2016, me të cilat vlerësohet shkalla sektoriale e përmbushjes së cakut të periudhës së shikuar me vlerësimin e ARRU.

Për herë të parë ofruesit e shërbimeve në nivel të sektorit kanë arrit shumë afër realizmin e objektivit të përcaktuar për shkallën e arkëtimit, e cila mund të konsiderohet si arritje relativisht e mirë, ndërsa kemi dështim të shumës së faturimit, e cila në masë të madhe e devalvon shkallën e arkëtimit, pasi të njëjtat nuk kanë njëtrajtshmëri dhe konsistencë të tyre.

5.4. Përcaktimi I tarifave për shërbimet e ujit 2015-2017

Tarifat për periudhën 2015 - 2017 janë përcaktuar nga të dhënat e Biznes Planeve Rregullatore (BPRR) të deklaruara nga ofruesit e shërbimeve, gjatë vitit 2014, të cilat janë analizuar dhe vlerësuar, si dhe janë mbajtur konsulta intensive reciproke mes ofruesve të shërbimeve dhe ARRU dhe përfundimisht janë aprovuara nga ARRU.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2016 janë aprovuar edhe biznes planet e ofruesve të shërbimeve për vitin 2017, të cilat tani janë në harmoni me Biznes Planet Rregullatore nga procesi tarifar 3 vjeçar 2015-2017.

Metodologjia e tarifave të aplikuara ka definuar procedurat dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifave, që duhet zbatuar për të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, duke marrë në konsideratë edhe rishikimin e jashtëzakonshëm eventual të tyre gjatë vitit 2017.

Monitorimi i përmbushjes së objektivave, analiza e të dhënave, nxjerrja e indikatorëve me të cilët është vlerësuar shkalla e përmbushjes së objektivave dhe lëvizjet inflatore, kanë qenë ndër faktorët kryesor ndikues për përcaktim të tarifave të vitit 2017. Në fund të dhjetorit 2016 ARRU, ka përcaktuar tarifat e aplikueshme gjatë vitit 2017 për të gjitha kompanitë e rregulluara të shërbimeve publike të ujit.

Në pasqyrën e mëposhtme tabelare janë pasqyruar tarifat volumetrike të shërbimeve publike për furnizim me ujë dhe ato të shërbimeve të ujërave të ndotura të aplikuara gjatë periudhës së përmbyllur tarifore 2012-2014, tarifat e aplikuara për vitin 2015, 2016 dhe tarifat e aplikueshme për vitin 2017, me mundësi rishikimi për periudhën rregullatore të tarifave të vitit 2017, për çdo ofrues të shërbimeve dhe tarifat mesatare të sektorit në nivel të vendit.

Kompania	Grupimi i konsumatorëve	Njësi matëse	Tarifat e aplikuarra gjatë vitit 2012	Tarifat e aplikuarra gjatë vitit 2013	Tarifat e aplikuarra gjatë vitit 2014	Tarifat e aplikuarra gjatë vitit 2015	Tarifat e aplikueshme për vitin 2016	Tarifat e planifikuara për aplikim gjatë vitit 2017
KRU Prishtina	Shtëpiak	€/m ³	0.42	0.43	0.43	0.44	0.44	0.44
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.98	0.98	0.99	0.99	0.99
KRU Hidroregjioni Jugor	Shtëpiak	€/m ³	0.36	0.40	0.41	0.42	0.42	0.42
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.70	0.78	0.79	0.80	0.80	0.80
KRU Hidrodrini	Shtëpiak	€/m ³	0.28	0.29	0.29	0.30	0.30	0.30
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.55	0.60	0.60	0.61	0.61	0.61
KRU Mitrovica	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.45	0.45	0.45	0.45	0.45
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.93	0.96	0.96	0.96	0.96	0.96
KRU Radoniqi	Shtëpiak	€/m ³	0.40	0.43	0.44	0.45	0.45	0.45
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.88	0.91	0.92	0.93	0.93	0.93

KRU Bifurkacioni	Shtëpiak	€/m ³	0.44	0.45	0.45	0.46	0.46	0.46
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.97	0.97	0.98	0.98	0.98
KRU Hidromorava	Shtëpiak	€/m ³	0.40	0.41	0.41	0.41	0.41	0.41
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.90	0.85	0.85	0.85	0.85	0.85
SEKTORI	Shtëpiak	€/m ³	0.39	0.41	0.41	0.42	0.42	0.418571429
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.85	0.86	0.87	0.88	0.88	0.874285714

Tabela nr. 4. Tarifat komulative volumetrike për shërbimet e ujit për të dy grupimet e konsumatorëve 2012-2017

Furnizimi nga "Iber-Lepenci" Prishtinë, - KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë	0.0187 €/m ³
Furnizimi nga "Iber-Lepenci" Prishtinë, - KRU Prishtina" sh. a. Prishtinë	0.0455 €/m ³
Furnizimi nga KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë për Mitrovicën e Veriut	0.17 €/m ³

Tabela nr.5. Tarifat e vitit 2017 për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë nga NH "Iber-Lepenci" sh. a. Prishtinë me të cilat furnizohet KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë dhe KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë dhe tarifa e ujit me shumicë me të cilën furnizohet Mitrovica e veriut nga KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë.

Tarifat e pasqyruara në tabelat nr. 4 dhe nr. 5, janë pa TVSH.

Gjatë këtij viti raportues, duke marrë parasysh nivelin e humbjeve të ujit, inkasimin e ulët, dhe duke u bazuar në indikatorët kyq të performancës së ofruesve të shërbimeve, ARRU ka lëshuar Urdhëresën Tarifore që konsumatorët e shërbyer nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit do të vazhdojnë të marrin faturat e tyre me ngarkesa të njëjta financiare sikurse ato të vitit 2016 edhe gjatë vitit 2017 për sasinë e njëjtë të ujit të faturuar - tarifat kanë ngelur të pandryshuara që nga viti 2015.

Gjatë vitit 2016 (pas emërimit të Drejtorit të ARRU), janë bërë disa korrigjime të tarifave dytësore të shërbimeve të ujit të cilat janë konsideruar të domosdoshme për të mbështetur implementimin e ligjit, rregullimin e tyre me akte interne të ofruesve të licencuar të shërbimeve dhe me qëllim të lehtësimit dhe stimulimit të konsumatorëve për qasje në shërbimet e ujit. Korrigjimet janë bërë në Urdhëresat Tarifore të Shërbimeve, dhe atë në:

- (i) Lidhjet e paautorizuara – është larguar gjoba për lidhje dhe ri-lidhje në shërbimet e ujit e cila ka qenë e përcaktuar në vlerë 100 €. Janë udhëzuar ofruesit e shërbimeve për mënyrën e veprimit dhe ndjekjen e mundshme penale të konsumatorëve të tillë.
- (ii) Moskryerja e riparimeve të rrjedhjeve – është larguar gjoba për moskryerje të riparimeve të rrjedhjeve të ujit në objektin e konsumatorit e cila ka qenë e

përcaktuar në vlerë 100 €. Ofruesit e shërbimeve janë udhëzuar që rastet e tilla ti rregullojnë përmes akteve interne të tyre.

- (iii) Tarifa administrative për lidhje në shërbime të ujit – është zbritur nga 50.00 € në 5.00 € me qëllim të lehtësimit të ngarkesës financiare të konsumatorëve të rinj që kërkojnë shërbime të ujit, si dhe për të stimuluar konsumatorët që aktualisht i shfrytëzojnë shërbimet e ujit në mënyrë jo-legale të legalizohen në shërbimet e ujit, në mënyrë që të ngarkohen me tarifa reale konsumi. Përfitimet nga ky veprim konsiderohen të dyanshme dhe në aspektin afatgjatë shumë dobipurëse për kompaninë.

Si përfundim vlen të theksohet se qëndrueshmëria financiare e ofruesve të shërbimeve vërteton faktin se tarifat e shërbimeve kanë qenë të përcaktuara mbi kriteret e mira ekonomike, duke marrë parasysh aktet rregullative, metodologjitë dhe politikat rregullatore të aprovuara ma parë edhe pse ofruesit e shërbimeve është dashur të jenë shumë ma eficient.

Për eficientësinë e ofruesve të shërbimeve, palët e interesit janë njoftuar në vazhdimësi dhe të gjitha publikimet janë bërë dhe bëhen në koordinim dhe konsultim paraprak.

Në tabelën Nr.6 për ilustrim dhe krahasim janë paraqitur tarifat volumetrike të disa vendeve të Rajonit

Nr	Shteti	Qyteti	Konsumatorët	Tarifa volumetrike për ujë dhe kanalizim €/m ³
1	Kosovë	Mesatarja	Shtëpiak	0.42
			Jo shtëpiak	0.88
2	Shqipëri	Tiranë	Shtëpiak	0.41
			Jo shtëpiak	1.10
2	Shqipëri	Durrës	Shtëpiak	0.72
			Jo shtëpiak	1.34
3	Maqedoni	Shkup	Shtëpiak	0.48
			Jo shtëpiak	1.07
4	Mali i Zi	Herceg Novi	Shtëpiak	1.05
			Jo shtëpiak	2.16
5	Serbi	Novi Sad	Shtëpiak	0.59
			Jo shtëpiak	1.39
6	Bosnja dhe Hercegovina	Sarajevë	Shtëpiak	0.61
			Jo shtëpiak	0.85
7	Kroacia	Osijek	Shtëpiak	1.57
			Jo shtëpiak	2.17

Tabela Nr. 6, tarifat e vendeve të rajonit

Për vitin 2017 janë përcaktuar caqet (objektivat) për çdo ofrues të shërbimeve veç e veç, të cilat kanë dalë nga performanca e tarifave të përcaktuara gjatë vitit 2016. Të gjithë ofruesit e shërbimeve janë njoftuar për caqet e përcaktuara për vitin aktual.

Monitorimi i performancës së arritur të ofruesve të shërbimeve, në raport me caqet e përcaktuara, rishikimi i tarifave për të përcaktuar të njëjtat për shërbimet e furnizimit me ujë dhe shkarkimin e ujërave të ndotura gjatë viti 2017, analiza dhe vlerësimi i të dhënave nga të cilët nxjerrim treguesit kryesor operativ dhe financiar, konsiderohen si obligime kontraktuale në mes ARRU-së dhe ofruesve të shërbimeve, prandaj gjatë vitit 2017 do të vazhdojmë me përmbylljen e detyrave tona në monitorimin e tyre.

5.5. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit

Përmes këtij aktiviteti monitorohet performanca e ofruesve të shërbimeve në përmbylljen e përgjegjësi të tyre dhe përcillet progresi nga viti në vit i përmirësimit të shërbimeve. Ky aktivitet gjithashtu shërben për nxitjen e konkurrencës (benchmarking) mes ofruesve të shërbimeve.

Arritjet maten në bazë të treguesve kyç të performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin.

Performanca matet kundrejt mesatares së sektorit, si dhe performancës vetanake në vitin 2016 në raport me vitin 2015.

Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat ofruesit e shërbimeve i paraqesin në ARRU në baza mujore dhe raportimin vjetor, në pajtim me obligimet raportuese që kanë ndaj ARRU.

Raportet janë përmbyllur në baza mujore përmes sistemit të raportimit financiar, operativ, shërbimeve ndaj konsumatorëve (ROFK), si dhe planit të monitorimit vjetor (PMV) i cili parasheh raportimin vjetor sipas konceptit rregullator. Për këtë qëllim ARRU ka dizajnuar 2 (dy) formate të raportimit: (i) raporti mujor dhe (ii) raporti vjetor. Këto formate u janë dorëzuar ofruesve të shërbimeve së bashku me udhëzimet përkatëse për mënyrën dhe formën e raportimit.

Sipas raporteve të kërkuara, është përditësuar në baza të rregullta edhe baza e të dhënave të ARRU e cila përbëhet nga dy programe softuerike ROFK dhe DB vjetore. Të dy programet mundësojnë procedimin e treguesve të performancës në mënyrë automatike, si dhe ofrojnë mundësinë e nxjerrjes së raporteve në forma dhe periudha kohore të ndryshme, varësisht nga kërkesat e caktuara.

Bazuar në këto të dhëna, pas analizave, si dhe verifikimit të tyre përmes procesit të auditimit si çdo vit edhe në vitin 2016 ARRU ka publikuar Raportin Vjetor të Performancës (për vitin 2015) në të cilin pasqyrohet performanca e përgjithshme e sektorit dhe e ofruesve të shërbimeve veç e veç (http://www.arru-rks.org/AnnualPerfor/RAPORTI_I_PERFORMANCES_2015_AL.pdf)

Në vijim, për informimin e lexuesit të këtij raporti, përmes disa prej treguesve kyç të performancës (TKP) është paraqitur performanca e përgjithshme e sektorit dhe performanca individuale për shtatë ofruesit e shërbimeve të cilët janë të licencuar nga ARRU. Me qëllim të

paraqitjes së krahasimit të zhvillimit, në nivel të sektorit janë paraqitur të dhënat e këtyre treguesve periudhë 5 vjeçare, ndërsa *performanca individuale* është paraqitur përmes krahasimit të zhvillimit në vitin 2016 në raport me vitin 2015.

Të dhënat e paraqitura për vitin 2016, janë të dhëna të pa audituara, pasi pasqyrat financiare të ofruesve të shërbimeve ende nuk janë përmbyllur, ndërsa të dhënat për vitin 2012, 2013, 2014 dhe 2015 janë të dhëna të audituara nga ARRU.

5.5.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Mbulueshmëria me shërbime të ujit nënkupton përqindjen e popullatës brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve të cilët ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Në zonën e shërbimeve të ofruesve të shërbimeve, vlerësohet se jetojnë një popullatë prej 1.7mil. banorë, prej të cilëve rreth 1,5 mil. banorë apo 90%, marrin shërbime të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullatës banojnë kryesisht në zonat rurale, të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ofruesit e shërbimeve.

Qasje në shërbimet e ujërave të ndotura kanë rreth 1.2 mil. banorë apo 69.5%.

Mbulueshmëria me shërbime	Ujësjellës	Ujëra të ndotura
2012	78%	56%
2013	82%	60%
2014	84%	62%
2015	87%	65%
2016	90%	69.5%


Tabela nr.7, Norma e mbulueshmërisë me shërbime të ujit për periudhën 2012-2016

Siq edhe shifet në tabelën nr. 06, mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit nga viti 2012-2016, është rritur për 12%, përderisa shërbimet e ujërave të ndotura për këtë periudhë janë rritur për rreth 13.5%. Investimet kanë qenë paralel në të dyja shërbimet. Investimet kryesisht janë bërë nga institucionet përgjegjëse vendore, donatorët ndërkombëtar, si dhe vet ofruesit e shërbimeve.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të cilët marrin shërbime në nivel të vendit për vitin 2016 është 322,895 konsumatorë.

Në diagramet e mëposhtme Nr.01 dhe Nr.02 është paraqitur performanca individuale e ofruesve të shërbimeve për vitin 2016 (e krahasuar me vitin 2015), lidhur me zhvillimet në aspektin e ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujëravë të ndotura.


- a) Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit – nënkupton përqindjen e popullsisë brenda zonës së shërbimit të cilët marrin shërbime të ujësjellësit të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.



Diagrami nr. 1, mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Siç shifet në diagramin e mësipërm nr. 1, mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit për shtatë ofruesit e shërbimeve në 2016 është 90%, dhe është 3% më e lartë se në vitin paraprak. Në të gjitha zonat e shërbimit të ofruesve të shërbimeve ka rritje të qasjes së popullatës në shërbime të ujësjellësit.

- b) Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura – nënkupton përqindjen e popullsisë brenda zonës së shërbimit të cilët kanë qasje në shërbimet e ujërave të ndotura të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.



Diagrami nr. 2, Norma (%) e Mbulueshmëria së popullatës me shërbimet e ujërave të ndotura

Siç shifet në diagramin e mësipërm nr. 02, mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura për shtatë ofruesit e shërbimeve në 2016 është 69%, dhe është 4% më e lartë se në vitin paraprak. Në të gjitha zonat e shërbimit të ofruesve të shërbimeve ka rritje të qasjes së popullatës në shërbime të ujësjellësit.


5.5.2. Uji i Pa faturuar (UPF)

Uji i pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet) – ndryshe i quajtur si “humbje e ujit”.

UPF paraqet humbjet teknike (rrjedhjet) dhe humbjet komerciale (lidhjet ilegale, pasaktësitë gjatë leximit të ujëmatësve, faturimi pa ujëmatës, etj). UPF nënkupton ujin i cili nuk sjell të ardhura për kompanitë, përderisa prodhimi dhe shpërndarja e tij krijojnë shpenzime.

Niveli i lartë i UPF ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe vazhdon të jetë ndër shqetësimet kryesore të sektorit.

Në diagramin e mëposhtëm Nr.03 është paraqitur performanca individuale e secilit ofrues të shërbimeve për vitin 2016 (e krahasuar me vitin 2015).



Diagrami nr. 3, Uji i pa-faturuar (UPF)

Niveli i ujit të pa-faturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët, gjatë vitit 2016, shprehur në përqindje, është në nivelin 57%. Në krahasim me vitin 2015, ky tregues ka shënuar zhvillim negativ me rritje 1%.

Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 8 është paraqitur niveli i ujit të pafaturuar në disa shtetet të rajonit. Të dhënat e kësaj table janë marrë nga databaza e IBNET.

Shteti	Viti	Treguesi
Shqipëria	2015	67%
Maqedonia	2014	60%
Kosova	2016	57%
Mali i Zi	2013	71%
Bosna dhe Hercegovina	2014	60%
Serbia	2015	39%

Tabela nr. 8 – UPF në vendet e rajonit (%)

UPF (Humbjet e ujit), mbetet një sfidë e madhe në këtë sektor për të gjitha ofruesit e shërbimeve, pa përjashtim.

Ofruesit e shërbimeve, duke u bazuar në 'Kornizën Strategjike për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit', të hartuar nga Qeveria e Kosovës (KNMU) duhet të vazhdojnë me aktivitete në zvogëlimin e humbjeve të ujit nën përkrahjen e "Programit Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale RWSSP Faza e V-të", programi i financuar nga Agjencioni për Zhvillim Zvicerian dhe Qeveria e Kosovës.

Zvogëlimi i UPF është përgjegjësi direkte e ofruesve të shërbimeve, të cilët përmes masave të ndërmarra gjatë aktiviteteve duhet të përmbushin obligimet e përcaktuara në bazë të strategjive, planifikimeve dhe masave të përcaktuara me akte nënligjore.

Një numër standardesh të përcaktuara nga rregullatori, të cilat duhet të përmbushen nga ofruesit e shërbimeve, janë drejtpërdrejtë të lidhura me UPF. P.sh. Ndërprerja e lidhjeve ilegale, paisja me ujëmatës për konsumatorë, matja e ujit të prodhuar, presioni minimal në rrjet, raportimi për UPF, etj.


ARRU, në vazhdimësi ka përkrahur dhe ka sfiduar objektivat e ofruesëve të shërbimeve, në reduktimin e humbjeve të ujit, përmes mekanizave të cilët i ka në dispozicion:

- Me procesin tarifor i udhëhequr nga ARRU, është rënë dakord me ofruesit e shërbimeve, për objektiva pragmatike vjetore për të reduktuar humbjet e ujit. Kostoja e aktiviteteve në përmbushjen e objektivave është përcjellur si pjesë e ngarkesës tarifore,
- Me qëllim të verifikimit të matjes së ujit të prodhuar, ashtu siç është specifikuar në rregulloren për standardet minimale të shërbimeve, është zhvilluar inspektim për shtatë (7) ofruesit e shërbimeve. Janë përpiluar raportet për secilin, me rekomandimet përkatëse. ARRU ka obliguar që në një afat kohor të arsyeshëm të gjithë ofruesit e shërbimeve, të vendosin matës të prodhimit të ujit në pikat ku aktualisht mungojnë,
- ARRU ka adresuar dhe bashkëpunuar me Qeverinë e Kosovës për adresimin e sfidës së "Reduktimit të humbjeve të ujit", në kuadër të 'Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021', me të cilën janë paraparë masa dhe aktivitete konkrete për zvogëlimin e humbjeve të ujit, përgjatë periudhës 2016-2021,

- ARRU ka raportuar sipas planit të veprimit të Qeverisë së Kosovës, sipas kërkesave të Komisionit Evropian për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit, me ç’rast në Rraportin e progresit të KE reduktimi i humbjeve të ujit është adresuar si sfidë e cila duhet përmbushur,
- ARRU ka vazhduar të monitoroj dhe raportojoj tek publiku i gjerë, nëse objektivat për reduktimin e humbjeve të ujit janë duke u përmbushur sipas dakordimeve me ofruesit e shërbimeve,
- ARRU me interes ka përcjellur dhe përkrahur shqetësimet e ofruesit të shërbimeve, për rritjen e konsumit të ujit nga institucionet fetare, si rezultat i shfrytëzimit të mundësisë së dhënë nga Ligji Nr.05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të ujit i cili i liron objektet e kultit nga pagesa e shërbimeve të ujit. Ky fakt pa dyshim se do të ndikojë në rritjen e normës së humbjeve të ujit,
- Ofruesit e shërbimeve duhet të përpiqen për të reduktuar humbjet e ujit në mënyre që të rrisin qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe operative. ARRU ka kërkuar (janë mbajtur takime të veçanta me secilin ofrues të shërbimeve) nga Bordet e Drejtorëve të ofruesit të shërbimeve, të cilët kanë përgjegjësi ligjore për mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të afarizmit të këtyre ofruesëve të shërbimeve për angazhimin (përveç tjarash) edhe në drejtim të zvogëlimit të humbjeve të ujit.

5.5.3. Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit paraqet raportin e mbledhjes së të ardhurave të faturuara gjatë vitit. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.



Diagrami nr. 04 Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit në nivel të sektorit për vitin 2016 është 86%. Në krahasim me vitin 2015, në nivel të sektorit, ky tregues ka shënuar zhvillim pozitiv me rritje 12%. Duhet theksuar se një ndër faktorët të cilët kanë ndikuar në përmirësimin e këtij treguesi ka qenë efekti I ligjit për

faljen e borxheve publike, pa lënë pas edhe masat ligjore të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve (ndërprerjet individuale dhe masat tjera ligjore e operative).

5.5.4. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës

Ky tregues paraqet proporcionin e konsumatorëve të pajisur me ujëmatës funksional, të ndarë me numrin e përgjithshëm të konsumatorëve të ofruesit të shërbimeve për vitin 2016.



Diagram nr. 05, Proporcioni (%) e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Në vitin 2016, mesatarja në nivel të sektorit të konsumatorëve shtëpiak me matje është 93%. Krahasuar me vitin 2015, ky tregues ka shënuar zhvillim pozitiv me rritje për 1%.

Norma e matjes tek konsumatorët komercial- industrial në vitin 2016 është në nivelin 97%, ndërsa uji i shfrytëzuar nga institucionet matet në nivelin 98%.

Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 9 është paraqitur proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në disa shtetet të rajonit. Të dhënat e kësaj table janë marrë nga databaza e IBNET.

Shteti	viti	treguesi
Shqipëria	2015	65%
Maqedonia	2014	89%
Kosova	2016	93%
Mali i Zi	2013	87%
Bosna dhe Hercegovina	2014	94%
Serbia	2015	94%

Tabela nr. 9, Proporcioni konsumatorëve me ujëmatës (%) në vendet e regjionit

5.5.5 Performanca e NHE-Iber Lepenci

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci' vetëm për pjesën e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj. O 'Drenas'.

Në tabelën nr.10 është dhënë një pasqyrë të treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Iber Lepenci', gjatë vitit 2016 krahasuar me vitin 2015.

Treguesi i performancës	2015	2016
Shkalla e arkëtimit	19%	71%
Norma e punës	1.09	0.88
Norma e mbulimit të punës	0.21	0.62
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.02	0.03

Tabela nr.10, Treguesit e Performancës së NHE 'Iber-Lepenci'

Shkalla e arkëtimit në vitin 2016, është ngritur nga 19% në 71%. Përderisa nga KRU "Prishtina" kjo kompani ka arritur arkëtimin e plote të faturimit(100%), nga KRU "Mitrovica" ka arrit që ti arkëtoj vetëm 35% të shumës së faturuar.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2016, kanë treguar performance jo të mirë, që d.th se kemi rritje të shpenzimeve operative për furnizimin të ujit me shumicë për keto dy KRU.

5.6. Inspektimi dhe zbatimi i standardeve të shërbimit

Edhe gjatë vitit 2016 vëmendje dhe fokus të veçantë i është kushtuar zbatimit të standardeve të shërbimit.

Përmes aktiviteteve të inspektimit është përcjellë zbatimi i rregullores për standardet minimale të shërbimeve në përgjithësi si dhe përmbushja e disa prej standardeve të shërbimit në veçanti siq janë: mënyra e matjes së ujit të prodhuar, zbatimi i taksës administrative për shfrytëzim të rrjetit të shërbimeve, zbatimi i vendimit të faturimit për objektet fetare, planifikimi për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, planifikimi i furnizimit me ujë dhe planifikimi i reduktimeve, implementimi i investimeve kapitale, zbatimi i formatit të ri të kontratës së shërbimeve dhe kartës së konsumatorit etj.

Në vazhdim të këtij kapitulli janë të paraqitur më detalisht disa prej standardeve të shërbimit të cilat janë përcjellë gjatë vitit 2016, veprimet e ndërmarra nga ARRU dhe rezultatet e këtyre aktiviteteve

5.6.1. Inspektimi i zbatimit të rregullores për standardet minimale të shërbimeve

Ky aktivitet është zhvilluar në bashkëpunim me projektin mbështetës të ARRU (financuar nga SDG) në të gjitha KRU-të me qëllim të grumbullimit të informatave rreth mënyrës së mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave teknike dhe komerciale në KRU si dhe nivelit të zbatimit të

standardeve të shërbimit. Për aktivitetet e inspektuara është përpiluar raporti i inspektimit. Në bazë të të gjeturave nga inspektimi janë organizuar punëtori për secilin ofrues të shërbimeve me rekomandime për përmirësimin e mënyrës së grumbullimit, ruajtjes së të dhënave dhe përmirësimin të nivelit të standardeve të shërbimit.

5.6.2. Verifikimi i mënyrës së matjes së ujit të prodhuar në të gjitha pikat e prodhimit.

Me qëllim të verifikimit të matjes së ujit të prodhuar, ashtu siq është specifikuar në rregulloren për standardet minimale të shërbimeve, është zhvilluar inspektim për shtatë (7) ofruesit e licencuar të shërbimeve. Gjatë këtij aktiviteti janë inspektuar të gjitha pikat e prodhimit për të cilat ofruesit e shërbimeve kanë deklaruar se bëhet matja e ujit të prodhuar. Inspektimi është zhvilluar në 56 pika të prodhimit të ujit. Janë përpiluar raportet për secilin ofrues të shërbimeve me rekomandimet përkatëse.

Në bazë të rekomandimeve të raportit të inspektimit, ARRU ka obliguar që në një afat kohor (janar 2017) të gjithë ofruesit e shërbimeve të vendosin matës të prodhimit të ujit në pikat ku aktualisht mungojnë.

Ky aktivitet do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2017, përmes inspektimeve verifikuese me qëllim të verifikimit të zbatimit të obligimeve të cilat ofruesit e shërbimeve i kanë marrë.

5.6.3. Inspektimi i zbatimit të akteve nënligjore, urdhëresave dhe vendimeve të ARRU.

Ky aktivitet ka përfshi inspektimin në terren, përgaditjen e raporteve të inspektimit, rekomandimet dhe inspektimet verifikuese për zbatimin e rekomandimeve për çështjet në vijim:

a) Verifikimi i zbatimit të taksës administrative për shfrytëzimin e rrjetit të shërbimeve të ujit sipas urdhëresës tarifore:

Sipas Urdhëresës Tarifore e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.06.2016 taksa administrative për shfrytëzimin e rrjetit të shërbimeve të ujit nga 50 euro është zvogëluar në 5 euro. Me qëllim të verifikimit të zbatimit të këtij ndryshimi është zhvilluar inspektim në të gjithë ofruesit e shërbimeve. Bazuar në të dhënat e gjetura katër (4) nga ofruesit e shërbimeve kanë vazhduar të aplikojnë taksën e vjetër administrative (50 euro). Të gjithë ofruesit e shërbimeve të cilët nuk e kanë zbatuar urdhëresën tarifore në fuqi, janë obliguar që të kompenzojnë konsumatorët e dëmtuar përmes bartjes së shumës për kompensim si parapagim. Numri i konsumatorëve të dëmtuar për të gjitha KRU-të është rreth 1150 konsumatorë. Inspektimi verifikues për kompensimin e këtyre konsumatorëve ka filluar në vitin 2016 dhe është në vazhdim edhe gjatë vitit 2017.

b) Verifikimi i zbatimit të vendimit për faturimin e objekteve fetare:

Ligji për rregullimin e shërbimeve të ujit (Ligji Nr. 05/L-42) i cili ka hyrë në fuqi me datën 30.01.2016, i liron objektet e kultit fetar nga pagesa e faturave. Me qëllim të verifikimit të zbatimit të ligjit, është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve. Gjatë inspektimit është vërejtur se përkundër hyrjes në fuqi të ligjit shumica e ofruesëve të

shërbimit kanë vazhduar faturimin e kësaj kategorie të konsumatorëve. Të gjithë ofruesit e shërbimeve janë obliguar që të ndalojnë faturimin e kësaj kategorie të konsumatorëve dhe të bëjnë kompensimin për periudhën kohore të faturuar nga hyrja në fuqi e ligjit. Si rezultat i inspektimit ka ndaluar faturimi i rreth 250 objekteve të kultit fetar. Procesi i inspektimit verifikues ka filluar në vitin 2016 dhe është në vazhdim edhe gjatë vitit 2017.

c) Verifikimi i mënyrës së faturimit të stafit të KRU.:

Gjatë inspektimeve kemi vërejtur se ngarkesa e cila i faturohet punonjësve të KRU “Mitrovica” nuk përputhet me mënyrën e faturimit të përcaktuar dhe aprovuar nga ARRU (urdhëresës tarifore dhe rregullores për standardet minimale të shërbimeve). Prandaj është zhvilluar inspektim te të gjithë ofruesit e shërbimeve për këtë çështje. Bazuar në të gjeturat e inspektimit KRU “Mitrovica” është obliguar t’i përmbahet mënyrave të faturimit të aprovuara nga ARRU. Inspektimi verifikues për përmbushjen e këtij obligimi është në proces.

d) Verifikimi i mirëmbajtjes së sistemit të kanalizimit:

Ofruesit e shërbimeve janë të obliguar të planifikojnë pastrimin e rrjetit të kanalizimit siq është specifikuar në Rregulloren për standardet minimale të shërbimeve. Për këtë qëllim është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve, të cilët janë obliguar për përpilimin e planeve dinamike për pastrimin e rrjetit të kanalizimit për vitin 2017. Inspektimi verifikues për përmbushjen e këtij obligimi është në proces.

e) Verifikimi i zbatimit të standardit të shërbimit për furnizim 24h me ujë dhe orarit të reduktiveve të ujit:

Ofruesit e shërbimeve në rastet kur nuk kanë marrëveshje për lirim nga ky standard i shërbimit janë të obliguar të furnizojnë konsumatorët me ujë 24h. Në rastet e përkohshme apo për periudhë më të gjatë kur kërkesa për ujë e tejkalon ofertën, siq është specifikuar në Rregulloren për standardet minimale të shërbimeve, ofruesit e shërbimeve duhet të përpilojnë programin e furnizimit të kufizuar i cili duhet të aprovohet nga ARRU. Për këtë qëllim është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve, të cilët janë obliguar për përpilimin e planeve të reduktiveve të ujit për vitin 2017. Inspektimi verifikues për përmbushjen e këtij obligimi është në proces.

f) Verifikimi i zbatimit të kontratës së shërbimeve/ kartës së konsumatorit:

Gjatë vitit 2016 ARRU ka aprovuar formatin e ri të Kontratës së shërbimeve dhe Kartën e konsumatorit. Me qëllim të verifikimit të zbatimit të këtyre dokumenteve është zhvilluar inspektim te të gjithë ofruesit e shërbimeve. Disa nga ofruesit e shërbimeve kanë filluar zbatimin e këtyre dy dokumenteve, ndërsa të tjerët janë obliguar për fillimin e zbatimit të tyre. Inspektimi verifikues për përmbushjen e këtij obligimi është në proces.

5.7. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK)

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, konform nenit 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-042, si dhe konform Nenit 5 të Rregullores për Komisionin këshillues të konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr.01/2016), është paraparë themelimi i Komisioneve

Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre Komisioneve.

Anëtarët e këtyre komisioneve janë zgjedhur në bazë të intervistimit të kandidatëve të propozuar nga Kryetarët e Komunave.

Komisionet këshilluese të konsumatorëve numërojnë gjithsej 32 anëtarë, janë të themeluara në shtatë (7) Rajone të Kosovës dhe me nga një anëtar janë të përfaqësuara të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, përveç veriut të Kosovës.

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve mbajnë takime në baza mujore, në të cilat përveç të tjerave shqyrtohen ankesat e konsumatorëve të cilët kanë parashtruar ankesë pranë KKK përkatëse.

Orari i takimeve të KKK publikohet në media dhe në ueb faqe të ARRU dhe këto takime janë të hapura për publikun.

Gjatë vitit 2016 janë mbajtur 78 takime të rregullta të KKK, takime në të cilat përveç shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve janë shqyrtuar edhe shumë çështje me rëndësi të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në interesin e konsumatorëve siç janë :

- a) Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve,
- b) Shqyrtimi i informacionit dhe analizimi i procedurave lidhur me shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve,
- c) Monitorimi i procesit të hulumtimit të opinionit të konsumatorëve për shërbime të ujit në Kosovë
- d) Informacion lidhur me lidhjen e Kontratave të Shërbimit ,
- e) Informacion lidhur me leximin e ujëmatësve ,
- f) Shqyrtimi i raportit të performancës ,
- g) Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve,
- h) Shqyrtimi i tarifave për uji dhe kanalizim për vitet në vijim,
- i) Shqyrtimi rreth hartimit të akteve nënligjore të ARRU-së.
- j) Shqyrtimi i çështjeve tjera të cilat janë në interes të konsumatorëve .

Në shumë raste gjatë vitit 2016 në këto takime kanë marrë pjesë edhe konsumatorët, përfaqësuesi i departamentit për mbrojtje të konsumatorëve (MTI) , OJQ-t dhe mediat.

5.7.1 Shqyrtimi i ankesave:

Tabela Nr.11, numri i ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të rajonale.

Në vijim është dhënë në formë tabelore (tabela Nr. 09) numri i ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të rajonale. RAJONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Prishtinë	31	20	13	16	14	20	9	16	23	20	15	15	212
Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjakovë	-	2	2	-	2	3	2	-	-	-	2	1	14
Prizren	-	-	-	-	-	-	1	2	-	1	2	-	6
Ferizaj	3	6	4	1	4	10	-	13	2	3	-	4	50
Gjilan	2	-	-	-	6	1	-	3	3	3	1	-	19
Gjithsej	36	28	19	17	26	34	12	35	28	27	20	20	302

Rezultati i shqyrtimit të ankesave të parashtruara është :

Nga 302 ankesa të parashtruara në KKK 260 janë zgjidhur, 2 janë dërguar njoftim për palët, 15 janë të palejuara (çështje të cilat nuk janë në kompetencë të KKK për tu zgjidhur), 23 nuk janë shqyrtuar për shkak të kalimit të afatit për ankesë dhe 2 lëndë janë në gjykatë.

Bazuar në analizimin më të hollësishëm të ankesave në vijim është paraqitur një përmbledhje e kategorizuar e ankesave:

a) Shpërndarja e ankesave sipas KKK regjionale:

Siç shihet edhe nga tabela Nr.09, numri më i madh i ankesave është evidentuar në KKK Prishtinë me 212 ankesa.

b) Natyra e ankesave:

- Kontestim i borxhit – 225 ankesa
- Zbritja apo shlyerja e borxhit – 16 ankesa
- Faturim paushall – 25 ankesa
- Faturim i lartë/mbifaturim – 26 ankesa
- Të tjera –10 ankesa

c) Kategoritë e konsumatorëve:

- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 265 ankesa janë nga konsumatorët shtëpiak
- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 37 ankesa janë nga konsumatorët joshtëpiak

5.8. Aktivitetet në konsolidimin institucional

Në këtë kapitull janë paraqitur aktivitetet në fushën e legjislativit, të cilat ARRU i ka ndërmarrë gjatë vitit 2016 në pajtim me Planin Strategjik 2015-2017 dhe në bazë të obligimeve dhe kompetencave të cilat i ka.

5.8.1. Aktivitetet në planin legjislativ

Gjatë vitit 2016 përveç harmonizimit të akteve nënligjore me Ligjin Nr.05/L-042 (të cilat janë shpjeguar në kapitujt e mësipërm), ARRU ka hartuar edhe dokumente tjera siç janë:

5.8.1.1. Hartimi i procedurave, udhëzuesve dhe dokumenteve tjera

- **“Karta e Konsumatorëve”** – bazuar në rregulloren për kartën e konsumatorit si dhe duke parë nevojën e informimit të konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre, me përkrahjen e projektit mbështetës të financuar nga Qeveria Zvicerane, janë mbështetur ofruesit e shërbimeve në përpilimin e kartës së konsumatorit, është aprovuar nga ARRU.
- **“Kontrata për shërbime”** – bazuar në legjislacionin aktual, me përkrahjen e projektit mbështetës të financuar nga Qeveria Zvicerane, janë mbështetur ofruesit e shërbimeve në përpilimin e kontratës për shërbime të konsumatorit, është aprovuar nga ARRU.

5.8.2.2. Paralajmërimet

Gjatë viti 2016 është proceduar një (1) Paralajmërim për KRU “Mitrovica” për mos pagesën e taksës Vjetore të Licencimit (TVL).

5.8.2.3. Procedurat Gjyqësore

Nga shtatë (7) rastet që i kemi iniciuar në gjykatë në vitin 2012 (ndaj Ofruesve të Shërbimit për Grumbullimin dhe Deponimin e Mbeturinave) vetëm një (1) ka përfunduar me marrëveshje për pagesën e borxhit me KMDK.

Për tri (3) rastet e iniciuara në vitin 2014 ndaj ndërmarrjeve komunale të ujësjellësit në Shtërpce (NKP Shtërpce), Kaçanik (NKP Luboteni) dhe Mitrovicën e Veriut (NPK Vodovod Ibar) për arsye të mospagesës së gjobës së shqiptuar për operim pa licencë të shërbimit, nuk kemi marrë akoma përgjigje.

Gjatë vitit 2016, aktivitetet e ARRU lidhur me procedurat gjyqësore kanë qenë:

- Një (1) rast në Gjykatën Kushtetuese – rasti sipas ankesës KRM” Pastrim”Sh.A.Prishtinë;
- Një (1) rast i ri është iniciuar në proces gjyqësor - KRU”Mitrovica”Sh.A.Mitrovicë, për mos pagesë të TVL;

- iii. Proces gjyqësor i inicuar nga konsumatorët - dy (2) raste ndaj vendimeve të KKK

5.9. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA

Bashkëpunimi i hapur i ARRU me të gjitha palët e interesit (vendore dhe ndërkombëtare) përmes koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informatave, përvojave etj, me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive në sektorin e ujit ka qenë aktivitet i vazhdueshëm edhe gjatë vitit 2016. Në vijim në pika të shkurta janë paraqitur institucionet me të cilat ARRU ka bashkëpunuar gjatë vitit raportues dhe përmbledhjen e shkurtër të qëllimit dhe aktiviteteve të ARRU me këto institucione:

- a) **Bashkëpunimi me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor** Gjatë gjithë vitit raportues, ARRU i është përgjigjur të gjitha kërkesave të këtij komisioni, dhe jemi ftuar në takime për qështje të ndryshme.
- b) **Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)**
Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, edhe gjatë këtij viti ARRU ka vazhduar bashkëpunimin përmes një numri aktiviteteve në fushën e monitorimit të kualitetit të ujit si dhe jemi angazhuar në ofrimin e ndihmës për KRU, në përmbushjen e përgjegjësisë të cilat dalin nga UA 16/2012 për kualitetin e ujit.
- c) **Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarjeve Publike (NJPMNP) të MZHE**
ARRU ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e kompanive rajonale të ujësjes. Gjatë vitit 2016 kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta me qëllim të zhvillimit të sektorit.
- d) **Bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropian (MIE)**
Pregaditjet dhe raportimet sipas kërkesave të MIE për “Inputet e Raportit të KE-së për Kosovën”, për takimin e “Nën - Komitetit për MSA-së për Mjedis, Transport, Energji dhe Zhvillim Rajonal” dhe për Komisionin Ekzekutiv “Infrastruktura”. Pjesëmarrje në takime dhe punëtori të organizuara nga MIE lidhur me eksperiencat e shteteve tjera për procedurat e pregaditjes së raporteve dhe mënyrës së raportimit.
- e) **Bashkëpunimi me MTI** - ka vazhduar bashkëpunimi me MTI, posaqërisht me Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve. Në këtë drejtim kemi marrë pjesë në punëtoritë e organizuara nga ky departament përmes diskutimeve dhe prezantimeve. Në punëtorinë e organizuar me temën “Mbrojtja Konsumatorit” kemi kontribuar përmes prezantimit me temën “*Si duhet zbatohen procedurat për shqyrtimin e ankesave të Konsumatorëve*”. Përveq departamentit për mbrojtje të konsumatorëve kemi bashkëpunuar ngushtë edhe me Agjencinë e metrologjisë së Kosovës (AMK) të kësaj Ministrie, lidhur me ndryshimet në legjislacion sa i përket matësve të ujit, përmes pjesëmarrjes aktive të përfaqësuesëve të AMK me prezantime në punëtoritë e organizuara nga ARRU dhe shkëmbimit të informacioneve.

- f) Bashkëpunimi me pushtetin lokal** – me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të favorshme për furnizim me ujë të konsumatorëve, ARRU, përmes takimeve të mbajtura me përfaqësues të pushtetit lokal (Mamushë, fshati Lubizhdë e Hasit etj) si palë ndërmjetësuese ka dhënë kontribut direkt në zgjidhjen e problemeve të shfaqura sa i përket ndërhyrjeve në zonat e shërbimit të ofruesve të shërbimit.
- g) Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit Ndër- Ministror të Ujit (KNMU)**, e cila zyre funksionon në kuadër të Kryeministrit. Gjatë tërë vitit kemi pasur shumë takime, që kanë të bëjnë me punën e gjithëmbarshme të ofruesve të licencuar të shërbimeve dhe donatorëve ndërkombtar.
- h) Bashkëpunimi me SHUKOS** (Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës) – gjatë vitit 2016, përveç bashkëpunimit të rregullt të cilin e kemi me këtë Shoqatë, stafi përgjegjës i ARRU ka marrë pjesë në punëtoritë e organizuara të kësaj Shoqate duke dhënë kontribut në përpilimin e akteve të brendshme ligore të ofruesëve të shërbimeve. Lidhur me këtë çështje janë mbajtur disa takime. Përveç punëtorive të mbajtura në Kosovë ARRU ka marrë pjesë edhe në punëtoritë dhe seminarët të cilat kjo shoqatë I ka organizuar në bashkëpunim me SHUKALB (Shoqata e ujësjetës kanalizimeve të Shqipërisë). Në punëtorinë e organizuar nga SHUKOS/SHUKALB, ARRU ka ndarë eksperiencat e veta përmes prezantimit me temën *“Aplikimi i standardeve të shërbimit si obligim nga licencimi – mbikëqyrja përmes inspektimit”*
- i) Bashkëpunimi me Entin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU)**, Shqipëri - bashkëpunim I rregullt i formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Janë mbajtur takime dhe vizita të ndërsjellta me qëllim të shkëmbimit të përvojave.
- j) Bashkëpunimi me Komisionin Rregullator Shtetëror për Energji dhe Ujë të Sofjes (SEWRC)** - së bashku me disa deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga komisioni për BPMPH, kemi vizituar këtë institucion dhe Komisionin e Kuvendit të Republikës së Bullgarisë që e mbikëqyrë këtë institucion. Qëllimi i vizitës ka qenë marrja e përvojave nga të dyja komisionet e Bullgarisë.
- k) Bashkëpunimi me përfaqësuesit e donatorëve** (SDC, USAID, KFW, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave në Kosovë. Janë mbajtur takime, shkëmbim i përvojave, informatave dhe pjesëmarrje në punëtori të ndryshme me interes për sektorin.
- Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, vlen të theksohet bashkëpunimi me DORSCH/CDI (projekti implementues i fazës V –të për rehabilitimin e sistemeve rurale të ujësjetës, i financuar nga Qeveria Zvicerane). Përmes databazës e cila është dorëzuar në ARRU nga DORSCH/CDI si dhe takimeve të shumta me qëllim të informimit, jemi përditësuar me informata lidhur me zgjerimin e zonave të shërbimit të ofruesve të shërbimit. Duke qenë se kusht themelor për investime në sistemet rurale të implementuara nga ky projekt ka qenë nënshkrimi marrëveshjes mes Komunitetit dhe ofruesit të shërbimeve, ARRU

është munduar ti njoftojë të gjithë palët e interesuara lidhur me procedurat për përfitime nga ky projekt (siq edhe ka qenë rasti i rajonit të Zhupës).

- l) Bashkëpunimi shoqatën ndërkombëtare të ujit IWA** (anëtare e së cilës është edhe ARRU)

- m) Bashkëpunimi me IAWD /DANUBIS** - me qëllim të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave në platformën e përbashkët on-line, me përkrahjen e IWAD dhe DANUBIS është zhvilluar formati i raportimit (DCM-P). Përmes pjesëmarrjes në takime dhe punëtori të mbajtura brenda dhe jashtë vendit, stafi i ARRU është trajnuar në përdorimin e kësaj platform si dhe ka kontribuar në avancimin e saj. Sipas obligimeve të marra me rastin e nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit, ARRU ka bërë përkthimin e manualit për përdorimin e platformës të dedikuar për institucionin menaxhues, ndërsa manuali për përdoruesit e ofruesëve të shërbimeve është në procesin e përkthimit.

- n) Bashkëpunimi me DANUBIS** (Programi i Bechmarkingut të vendeve të Regjionit të Danubit), ARRU vazhdon të jetë pjesë e rrjetit ndërkombëtar për të dhëna operative, financiare dhe shërbimeve me konsumatorë, program ky i Bankës Botërore i njohur me emrin IBNET

- o) Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit** - Drejtori i ARRU, në cilësinë e institucionit menaxhues (IM) për mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e platformës së performancës së ofruesëve të shërbimeve për Kosovë, ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me shoqatën ndërkombëtare të kompanive të ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub (IAWD)-DANUBIS. Ky memorendum është nënshkruar edhe me pëlqimin e Ministrisë së Punëve të Jashme të Republikës së Kosovës, konkretisht ministrit.

Me të gjitha palët (Kosovare dhe ato jashtë vendit) përmes takimeve të drejtpërdrejta, punëtorive dhe prezantimeve, ARRU ka dhënë kontribut duke paraqitur qëndrimin e vet lidhur me arritjet dhe ngecjet e sektorit. Bashkëpunimi me të gjitha palët gjithashtu na ka ndihmuar të informohemi me zhvillimin e sektorit dhe përvojat e vendeve tjera.

5.10. RELACIONET ME PUBLIKUN

5.10.1. Bashkëpunimi me media

Gjatë vitit 2016 përmes deklaratave për shtyp, opinioni publik është informuar për aktivitetet e Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit në përgjithësi.

Me qëllim të informimit të konsumatorëve, sensibilizimin e opinionit për rolin e KKK-ve, si dhe për të inkurajuar konsumatorët për pjesëmarrje në takime të KKK, ARRU përmes gazetave ditore çdo muaj ka publikuar orarin e takimeve mujore të KKK në shtyp dhe në ueb-faqen e ARRU-së.





Për informimin e të drejtave të konsumatorëve, është përgatitur një njoftim publik, i cili është lancuar në televizionin publik RTK gjatë muajit dhjetor. Ky njoftim është përgatitur me qëllim të informimit të konsumatorëve për Kartën e Konsumatorëve, rolin dhe detyrat e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, si dhe adresën e duhur të parashtrimit të ankesave nga konsumatorët në rastin e pakënaqësive ndaj KRU-ve.

Përmes ueb faqes www.arru-rks.org konsumatorët kanë mundësi të informohen detaisht lidhur me të gjitha aktivitetet e KKK-ve dhe ARRU-së.

5.10.2. Hulumtimi i opinionit të konsumatorëve për shërbimet e ujit

Në dhjetor të vitit 2016, me iniciativë dhe financim të ARRU, është realizuar një hulumtim i opinionit të konsumatorëve për shërbime të ujit në Kosovë nga N.SH. "Kosovo Management Institute". Temat (pyetjet) e anketës janë përcaktuar nga ARRU dhe KKK, pyetje të cilat kanë përfshi aspektin financiar, teknik dhe shërbimin me konsumatorë. Anketimi është realizuar me konsumatorë shtëpiak në shtatë (7) rajone të Kosovës dhe ka përfshirë njëzet e tetë (28) komuna të rajoneve të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit, Ferizajt dhe Pejës në zonat e shërbimit në të cilat KRU-të ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit. Janë anketuar gjithsejt 1143 konsumatorë shtëpiak . Ky aktivitet ka qenë i monitoruar nga ARRU dhe Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve.

Në vijim përmes diagrameve janë paraqitur rezultatet e këtij hulumtimi për disa nga temat më me rëndësi:



6. REKOMANDIMET

Me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të këtij sektori jetik për qytetarët, të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të angazhohen maksimalisht në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale dhe ligjore.

- Ofruesit e shërbimeve të obligohen nga akcionari që të implementojnë “Kornizën strategjike për zvogëlimin e ujit të pafaturuar”, e hartuar nga zyra e kryeministrit (sekretariati i KNMU),
 - Vendosjen e marrëveshjes së performancës ndërmjet Njesisë së Politikave dhe Monitorim për Ndërmarrjet Publike dhe Bordeve të Drejtorëve për Kompanitë Rajonale të Ujësjes, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.
- Qeveria së bashku me Kuvendet Komunale, ofruesit e shërbimeve dhe ARRU të vazhdojë angazhimin për integrimin e sistemeve rurale në kuadër të Kompanive Rajonale (sistemet të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të)
- Kuvendet Komunale të mbështesin ofruesit e shërbimeve në ndalimin e keqpërdorimeve të ujit
 - a) Reduktimin e ujit të pa faturuar,
 - b) Ngritjen e nivelit të arkëtimit dhe faturimit,
 - c) Ngritjen e kapaciteteve të ujit – zhvillimin e burimeve të reja,
- Të gjitha palët e interesit në sektor (Qeveria, Kuvendet Komunale, ofruesit e shërbimeve, donatorët, etj) të **kenë bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë gjatë planifikimit të mjeteve për investime** dhe gjatë caktimit të prioritetëve të investimeve.

Aprovimi i këtyre rekomandimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si dhe zbatimi i tyre nga të gjitha palët do të ndikojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve me ujë dhe kanalizim.

7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, buxhetin e vet e siguron nga Buxheti i Kosovës, ndërsa Taksa Vjetore e Licencimit e cila është e barabartë me shpenzimet buxhetore të ARRUsë, derdhet në buxhetin e Kosovës.

Te hyrat e planifikuara për vitin fiskal 2016 kanë qenë 180,018.67€, të inkasuara 187,412.00€ apo shprehur në përqindje 106.61% që do të thotë se ARRU Taksën vjetore të Licencimit e ka inkasuar 100%, ndërsa ka mbledhur borxh nga KRU 'Mitrovica' për vitin e kaluar në vlerë prej 7,393.78 €.

Duhet theksuar se Taksa Vjetore e Licencimit për vitin 2016 është kalkuluar për gjashtë muaj kalendarik, për arsye të pamundësisë së licencimit të ofruesve të shërbimeve, si rezultat i vonësive në zgjedhjen e Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të ARRUsë.

Nga data 31 tetor 2015 deri në datën 31 maj 2016, të gjithë ofruesit e shërbimeve kanë operuar pa licencë të shërbimit, dhe si rrjedhojë edhe taksa vjetore e licencimit (TVL) për vitin 2016 është llogaritur vetëm për gjashtë muaj kalendarik.

Është nxjerrë Udhëzimi Administrativ 01/2016 i datës 30 qershor 2016 sipas të cilit lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit ka qenë 1.12%.

ARRU vitin fiskal 2016 e ka filluar me 358,732.00 € buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Me kërkesën e Ministrisë së Financave kemi kursyer 33,163.90 € dhe i kemi transferuar te kjo ministri për destincionin e kërkuar, si dhe me vendim të Qeverisë Nr.01/123 kemi pasur shkurtim tjetër buxhetor në vlerë prej 20,425.41 €.

Buxheti pas korigjimit ka qenë 305,145.00 €, të shpenzuara 304,579 € apo shprehur në përqindje 99.82%.

Buxheti nuk është shpenzuar sipas planifikimit, për arsye se me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit, kompetencat për të zhvilluar procedurën të prokurimit kanë kaluar te AQP – arsye kjo që ka shkaktuar pengesa kryesore në mos shfrytëzimin e buxhetit sipas planifikimit.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë më të detajuar Raporti Financiar për vitin 2016.

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	186,970.00	186,970.00
Mallra dhe shërbime	114,070	113.610.00
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	4,105.00	3,999.00
Total Buxheti	305,145.00	304,579.00

Tabela 12: Buxheti i ARRU për 2016

ARRU buxhetin e vitit 2016 e ka shpenzuar në nivel 99.82%

Formatin e Raportit të detajuar financiar të aprovuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa Kuvendit të Republikës të Kosovës e keni të bashkangjitur (aneksi së 1)

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Zyra e Auditorit të përgjithshëm ka audituar ARRU-në për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2015.

Për vitin 2015 kemi pasur nëntë rekomandime të pa kualifikuara të cilat janë plotësuar menjëherë, ndërsa për vitin 2016 ende nuk jemi audituar nga Auditori i Përgjithshëm.

Emri i Auditimit: Auditimi i Pasqyrave Financiare të ARRU-së (ish ZRRUM-it) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015

Plani i Veprimit të Menaxhmentit - Për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it

Nr	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1	<p>Rekomandimi nr . 1 Prioritet i larte Drejtori i Pergjithshem duhet te siguroj se eshte bere nje analize per ti percaktuar shkaqet lidhur me klasifikimin e shpenzimeve dhe shpalosjen e duhur ne PVP</p>	<p>Ka bere identifikimin e ketyre mangesive dhe do te nxjerr rregulloren per menagjimin e rrishtit si dhe kontrollet e vazhdueshme duke analizuar kerkesat bugjetore klasifikimin e tyre si shtimin e raporteve finaciare nga ato mujore ne javore, duke u kujdesur per saktetin e tyre</p>	<p>Gjate tere vitit</p>	<p>Drejtori i ARRU-së (ish ZRRUK) dhe Kryesuesi i Dep. Të Adm. Dhe Financave</p>
2	<p>Rekomandimi ne.2 Drejtori i Pergjithshem duhet te siguroj se eshte zbatuar nje rishikim per plotesimin e e listes kontrolluese te vetevleresimit dhe qe eshte bere adresimi i fushave me dobesi perkatesisht vleresimin e rrishtit dhe raportimit</p>	<p>Me qene se ARRU nuk ka pasur Drejtor dhe zv.Drejtor 14 prill 2015-28 prill 2016- Tani drejtori eshte perzgjedhur dhe te gjitha aktivitetet per qeshtjet e adresuara jane duke u shqyrtuar dhe to te nxirret rregullorja per adresimin e pergjegjesive dhe do te percaktohen zyrtaret pergjegjes per analizat ,kontrollet dhe marrjen e pergjegjesise.</p>	<p>Shtator 2016. E perfunduar</p>	<p>Drejtori i ARRU</p>
3	<p>Rekomandimi nr.3 Drejtori i Pergjithshem duhet te siguro se eshte deleguar pergjegjesia e drejteperdrejte per menaxhimin e rrishtit tek nje zyrtar tek nje zyrtar perkates dhe te siguroj raportim mujor per zbatimin e kerkesave ne kete fushë dhe per rreziqet qe jane duke u menaxhuar.</p>	<p>Me qene se ARRU nuk ka pasur Drejtor dhe zv.Drejtor 14 prill 2015-28 prill 2016- Tani drejtori eshte perzgjedhur dhe te gjitha aktivitetet per qeshtjet e adresuara jane duke u shqyrtuar dhe to te nxirret rregullorja per adresimin e pergjegjesive dhe do te percaktohen zyrtaret pergjegjes per analizat ,kontrollet dhe marrjen e pergjegjesise</p>	<p>Shtator 2016 E perfunduar</p>	<p>Drejtori i ARRU</p>

<p>Rekomandimi 4-Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohej që të mbështete menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje të përshtatshme</p>	<p>Nxerrja e rregullores për raportimet financiare dhe operative të menaxhmentit të lartë</p>	<p>E përfunduar</p>	<p>Drejtori i ARRU dhe Menaxhmenti i mesëm i ARRU</p>
<p>Rekomandimi 5- Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen dhe realizohen në kategoritë adekuate për të ofruar një pamje më të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezentuara në PVF</p>	<p>Masat janë ndërruar menjëherë dhe kjo çështje nuk do të perseritet</p>	<p>Kjo do të deshmohet në PVF për vitin 2016</p>	<p>Kryesuesi i Departamentit për Admin dhe Financa</p>
<p>Rekomandimi 6-Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë realizimin e shërbimeve të telefonisë mobile përmes procedurave të duhura të prokurimit të cilat ofrojnë një blerje transparente</p>	<p>Kontrata është bërë konform marrëveshjes paraprake e cila është bërë në mes MAP dhe Vales 900 për të gjitha institucionet qendrore</p>	<p>E përfunduar</p>	<p>Drejtori i ARRU dhe Kryesuesi i Dep Admin dhe Financa</p>
<p>Rekomandimi -7 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve adekuate me rastin e aprovimit të pagesave dhe të sigurojë që me rastin e raportimit të shpenzimeve të gjitha transaksionet janë të sakta dhe të plota</p>	<p>E realizuar</p>	<p>E përfunduar</p>	<p>Kryesuesi i Dep Admin dhe Financa</p>
<p>Rekomandimi -8- Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsiderojë llogaritjet e kostos për mënyrën e aplikimit të meditjeve sipas rregullës për udhëtime zyrtare</p>	<p>Sipas rekomandimeve të mëparshme të Auditorit të Përgjithshëm në kemi vepruar por do të kërkojmë interpretim ligjor .</p>	<p>Gjatë tërë vitit</p>	<p>Drejtori i ARRU dhe Kryesuesi i Dep të Administratës dhe Financave</p>
<p>Rekomandimi -9- Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë përpjekjet për të siguruar se të gjitha automjetet që i përkasin agjencisë janë regjistruar si automjete zyrtare dhe të vazhdojë përpjekjet për të</p>	<p>Që në fillim ashtu siç jeni të informuar edhe ju ekipi i auditimit në kemi bërë përpjekje të vazhdueshme me kërkesa zyrtare po ashtu edhe përmes emailave tek qendra e sigurimeve të automjeteve dhe</p>	<p>Kur të sigurohen tabelat zyrtare nga Ministria përkatëse sepse janë në proces të prokurimit.</p>	<p>Drejtori i ARRU dhe Kryesuesi i Dept e Admin dhe Financave</p>

siguruar tabelat zyrtare duke ndjekur kerkesat e duke ndjekur kerkesat e UA perkates	perpjekjet do te vazhdojne		
--	----------------------------	--	--

Shtojca 1: Raporti Financiar për vitin 2016 sipas formatit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Ferat Dragaj, Nr. 68

E-mail: info@arru-rks.org

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>